



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 2325, datë 28.06.2013

Për

“Shqyrtimin e propozimit të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., mbi disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Znj. Alketa	Mukavelati	Kryetare
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Znj. Elkeda	Domi	Anëtare
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. Mirela Xhelaj, në mbledhjen e datës 28.06.2013, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për shqyrtimin e propozimit të sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., për disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit”

BAZA LIGJORE:

1. Neni 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Pika 2 e nenit 137, neni 138 e vijues i ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**K.Pr.A**)
3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918 (**Rregullorja e Brendshme**);

4. Rregullore nr. 19 datë 14.06.2010 për “Aksesin dhe Interkoneksionin” miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010, e ndryshuar (**Rregullorja**);

K Ë SHILLI D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacion shpjegues mbi projektvendimin (**Relacioni**);
 2. Projektvendim i KD të AKEP për “Për shqyrtimin e propozimit të sipërmarrësit Altelecom Sh.a., për disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit”(**Projektvendimi**);
 3. Shkresat e sipërmarrësit Altelecom sh.a me Nr.1759 Prot.dhe Nr.1760 Prot.,datë 10.04.2013
 4. Shkresa e ASC me Nr.325 Prot., datë 27.05.2013;
 5. Shkresa e Abcom me Nr. 161 Prot., datë 24.05.2013;
 6. Shkresa e Primo me Nr.3077 Prot., datë 23.05.2013;
 7. Shkresa e Nisatel me Nr.1760 Prot., datë 27.05.2013;
- si dhe diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazën ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. Altelecom me shkresën Nr.1759 Prot., datë 10.04.2013 ka dërguar në AKEP propozime për amendimin e Ofertës Referencë të Interkoneksionit, duke kërkuar reduktim të të numrit të pikave të interkoneksionit, bazuar në përfundimin e procesit të migrimit në rrjetin NGN.
2. Ndryshimet e propozuara nga Altelecom konsistojnë në:
 - a. Në Nenin 9 Interkoneksioni me Altelecom, pikat 8 dhe 9, si dhe në Aneks 2, Interkoneksioni me rrjetin Altelecom, pika 1 Pjesa e përgjithshme, paragrafi i parë dhe i dytë aktual:

Rrjeti i Abtelecom për qëllime të interkoneksionit është ndarë në 1 zonë kombëtare, 12 zona rajonale dhe brenda secilës zonë rajonale ka zona lokale interkoneksioni. Këto zona interkoneksioni janë paraqitur së bashku me kodet përkatëse të numeracionit në Aneks 17 ”Zonat e Interkoneksionit dhe Numeracioni i Altelecom”.

*Altelecom ofron Pikë Interkoneksioni në zonën kombëtare, **cdo zonë rajonale dhe në ato zona lokale ku Altelecom ka central lokal** dhe sipas mundësive teknike për të ofruar intrekoneksion. Pika e interkoneksionit lidhet me centralet e interkoneksionit të Altelecom dhe Operatorit Përfitues. Vendodhja e pikës së interkoneksionit varet nga forma e interkoneksionit. **Për interkoneksionin e bashkëvendosur në Altelecom pikat e interkoneksionit ndodhen në centralet respektive të Altelecom.** Centralet ku*

ekziston mundësia për interkoneksion paraqiten ne **Aneks 17 "Zonat e Interkoneksionit dhe Numeracioni i Albtelecom"**.

të ndryshohen si më poshtë:

Rrjeti i Abtelecom per qellime te interkoneksionit eshte ndare ne 1 zone kombetare, 2 zona rajonale dhe brenda seciles nga keto zona rajonale ka nga nje zone lokale interkoneksioni. Keto zona interkoneksioni jane paraqitur se bashku me kodet perkatese te numeracionit ne Aneks 17 "Zonat e Interkoneksionit dhe Numeracioni i Albtelecom".

"Albtelecom ofron Pike Interkoneksioni ne zonen kombetare, ne zonat rajonale te Tiranes dhe Durrësit dhe ne zonen lokale te Tiranes dhe Durrësit dhe sipas mundesive teknike per te ofruar intrekoneksion. Pika e interkoneksionit lidhet me centralet e interkoneksionit te Albtelecom dhe Operatorit Perfitues. Vendodhja e pikes se interkoneksionit varet nga forma e interkoneksionit. Per interkoneksionin e bashkevendosur ne Albtelecom pikat e interkoneksionit ndodhen ne centralet respektive te Albtelecom ne Tirane dhe/ose Durrës. Centralët ku ekziston mundësia per interkoneksion paraqiten ne Aneks 15 "Pikat e Interkoneksionit".

- b. Në Aneks 2, Interkoneksioni me rrjetin Albtelecom, pika 7.1.3,7.1.7 dhe 7.1.8 dhe në Aneks 6, Ceshtje Teknike, pika 3.1, ne vend te hapësirës boshe që I lejon operatorit tjetër përcaktimin/zgjedhjen e pikave rajonale dhe lokale të interkoneksionit me Albtelecom, të shtohet togfjaleshi "Tirane /Durrës".
- c. Në Aneks 15, Pikat e Interkoneksionit me Albtelecom, lista e pikave rajonale te interkoneksionit te reduktohet nga 12 pika në 2 pika (Tirane dhe Durrës) dhe lista e pikave lokale të interkoneksionit të reduktohet nga 17 pika në dy pika (Tirane dhe Durrës).
- d. Në Aneks 17, Zonat e Interkoneksionit dhe Numeracioni i Albtelecom, paragrafi i parë:

Albtelecom ofron zona Lokale dhe Rajonale të Interkoneksionit te cilat korrespondojnë me strukturën që Albtelecom iu ofron pajtimtarëve të Rrjetit të Tij, të cilat së bashku me kodet e numeracionit (NDC) janë paraqitur në tabelën në vijim. Zonat lokale të interkoneksionit janë të tilla vetëm në kuadër të zonës rajonale korresponduese.

të ndryshohet në

Albtelecom ofron zonë Lokale dhe Rajonale Interkoneksioni në zonën gjeografike të Tiranës dhe Durrësit kodet e numeracionit (NDC) dhe dipaazoni i SN-ve janë paraqitur në tabelën në vijim..

- e. Albtelecom propozon gjithashtu ndryshime në përkufizimin e termave "facilitetet shoqëruese" dhe "plan numeracioni" si dhe përfshirjen në bazë ligjore të amendimeve të Ligjit 9918.

3. Albtelecom me shkresën Nr.1760 Prot., datë 10.04.2013 , “*Mbi ndryshimet ne rrjetin e Albtelecom sh.a*”, dërguar sipërmarrësve të komunikimeve elektronike të interkonektuar me Albtelecom, ka njoftuar operatorët se duke filluar nga data 08.06.2013 Albtelecom do te ofroje sherbimet e interkoneksionit per operatoret ekzistues dhe operatoret qe kerkojne te interkonektohen rishtazi vetem ne 2 Pika Interkoneksioni Kombetare, 2 Pika Interkoneksioni Rajonale dhe 2 Pika Interkoneksioni lokale brenda zonave rajonale te Tiranes dhe Durrësit, aty ku me rrjetin e ri do jene centralet soft switch te Albtelecom. Keshtu rrjeti i Albtelecom per qellime interkoneksioni do te jete i ndare ne 1 zone kombetare, 2 zona rajonale dhe 2 zona lokale brenda zonave perkatese rajonale. Albtelecom sh.a informon operatorët se ky ndryshim kryhet për shkak se Albtelecom ka realizuar kalimin e plote ne teknologjine IP dhe migrimin ne rrjetin NGN/NGA dhe se tashme, rrjeti Albtelecom ka nje arkitekture te re dhe kjo po sjell efekte edhe ne interkoneksionin mes rrjeteve me te gjithë operatorët per shkak te ndryshimit te topologjise se rrjetit dhe heqjen nga perdorimi i te gjithë centraleve TDM duke u perqendruar ne vetem 2 centrale softswitch ne Tirane dhe Durres.
4. AKEP me shkresën nr.710/1 prot. Datë 19.04.2013, “*Ne lidhje me shkresat e Albtelecom me Nr.1759 Prot., dhe Nr. 1760 Prot .. date 10.04.2013*” është shprehur se ndryshimet e propozuara nga Albtelecom janë shumë të mëdha dhe kane efekte të konsiderueshme mbi operatorët e tjerë të interkonektuar me Albtelecom dhe mbi tregun në përgjithësi, dhe se këto ndryshime duhet t’i njoftohen operatorëve të paktën 6 muaj përpara dhe jo 2 muaj, dhe se ndryshimet e propozuara po shqyrtohen nga AKEP, i cili do dalë me vendim-marrje për propozimin e Albtelecom. Njëkohësisht AKEP i ka kërkuar Albtelecom të njoftojë operatorët për vazhdimin e ofrimit të aksesit në pikat aktuale të interkoneksionit dhe sipas zonave aktuale të interkoneksionit dhe se cdo ndryshim i mundshëm i tyre dhe afati i këtyre ndryshimeve do t’u njoftohet operatorëve pas miratimit nga AKEP të tyre.
5. Operatorët Abcom, ASC, Primo dhe Nisatel në vijim të propozimeve të Albtelecom, kanë dërguar ankesa në AKEP duke u shprehur se ndryshimet përbëjnë abuzim me pozitën dominuese të Albtelecom, pasi ndryshimet nuk propozohen mbi bazën e pamundësisë teknike të referuar në Rregulloren e Interkoneksionit.
6. AKEP pasi ka shqyrtuar propozimet e Albtelecom vlerëson se:
 - a. Ndryshimet e propozuara nga Albtelecom janë shumë të mëdha dhe kane efekte të konsiderueshme mbi operatorët e tjerë të interkonektuar me Albtelecom dhe mbi tregun në përgjithësi. Këto ndryshime të propozuara nga Albtelecom janë të ndryshme nga ato të propozuara nga AKEP në Analizën e Tregut Fiks si dhe në dokumentin e Rishikimit të Planit të Numeracionit, dokumenta të cilat gjithsesi nuk janë publikuar ende në versionin final të tyre, dhe përbëjnë pezullim të ofrimit të shërbimit të aksesit për interkoneksion në shumë pika interkoneksioni njëkohësisht. AKEP në dokumentin e Analizës, ka propozuar reduktim të segmenteve të interkoneksionit nga 3 në 2, duke bashkuar segmentin lokal dhe njëfish të terminimit në Albtelecom dhe në një të ardhme mundësinë për një segment terminimi, ndërsa ne dokumentin për rishikimin e planit të numeracionit ka propozuar zvogëlimin e zonave të numeracionit, por duke ruajtur 12 zona numeracioni në bazë qarqesh sipas ndarjes administrative. Këto propozime të AKEP janë berë më qëllim përshtatjen me zhvillimet urbane dhe rritjen e

fleksibilitetit në tarifim për operatorët. Gjithsesi ato nuk duhet të përbëjnë barrë të rëndë për operatorët, sic është argumentuar propozimi i AKEP në Analizë për ruajtjen e 12 zonave rajonale të interkoneksionit (duke i quajtur lokale), dhe ndryshimet e propozuara duhet të jenë graduale.

- b. Bazuar në nenin 6, pika 8 e Rregullores Nr. 19 datë 14.06.2010, për “Aksesin dhe Interkoneksionin”, në rastet e ndryshimeve të tilla, Altelecom ka detyrimin të informojë operatorët e tjerë mbi përfundimin e kohës së veprimit të elementit të rrjetit të përdorur për ofrimin e aksesit tek operatori përfitues, të paktën 6 muaj para. Ky detyrim i Rregullores së Aksesit dhe Interkoneksionit prevalon mbi çdo përcaktim të Ofertës Referencë të Interkoneksionit të Altelecom.
 - c. Bazuar në përcaktimet ligjore dhe të ofertës referencë të interkoneksionit, propozimi i Altelecom është objekt i miratimit ose jo, apo imponimit të ndryshimeve nga AKEP.
 - d. Kalimi i plotë në rrjetin NGN/NGA është një proces shumë pozitiv për Altelecom dhe tregun në tërësi, por ndryshimet që duhet të bëhen në marrëdhëniet me operatorët e tjerë të interkonektuar me Altelecom do të duhet të jenë objekt i një diskutimi të gjerë me palët e interesara, me qëllim maksimizimin e përfitimeve për përdoruesit fundorë duke ruajtur në të njëjtën kohë stimujt e Altelecom dhe operatorëve të tjerë për të investuar në rrjete dhe shërbime të reja.
7. AKEP arrin në përfundimin se propozimi i Altelecom nuk është i arsyeshëm në kushtet e tregut Shqiptar dhe grafiku kohor (afati 2 mujor) është shumë i shkurtër për ndryshime të tilla të mëdha. Pra propozimi i Altelecom nuk plotëson kërkesat e arsyeshmërisë dhe grafikut kohor të referuar në pikën 3 të nenit 52 të Ligjit 9918. Ndërkohë, AKEP do të nisë një proces diskutimi me palët e interesuara për ndryshime të mundshme në interkoneksion që do të duhet të kryhen në të ardhmen, në kushtet e kalimit të plotë në rrjetin NGN/NGA të Altelecom.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 135 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme, në zbatim të shkronjën c) të nenit 8 dhe nenin 52 të ligjit nr. 9918 dhe Rregullores Nr. 19 datë 14.06.2010 për “Aksesin dhe Interkoneksionin”, e ndryshuar,

V E N D O S :

1. Të mos miratoje propozimin e sipërmarrësit Altelecom sh.a, të dërguar me shkresën Nr.1759 Prot., datë 10.04.2013, “Dergohen propozime per amendimin e Ofertes Reference te Interkoneksionit te Altelecom Sh.a.”.
2. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit te AKEP: www.akep.al

3. Albtelecom sh.a dhe palët e interesuara kanë të drejtë të bëjnë ankim administrativ për këtë vendim brenda 30 ditëve nga marrja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R E

Alketa MUKAVELATI

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban KARAPICI
2. Benon PALOKA
3. Elkeda DOMI
4. Zamira NURCE